



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:187125
Datë: 05.02.2024
Numri i dokumentit: 05284836

PA1.nr.1660/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mehmet Ndrecaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Ferit Osmani, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarit B.Z., nga fshati ...– Komuna e Skenderaj, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-se, për të vendosur sipas ankesës së mbrojtës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj P.nr. 138/2023 të datës 27.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 02 Shkurt 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtës së të akuzuarit B.Z., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj P.nr.138/2023 i datës 27.10.2023, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj P.nr.138/2023 të datës 27.10.2023, i akuzuari B.Z., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-se, për të cilën i është shqiptuar denimi me burgim në kohezgjatje prej 10 (dhjetë) muaj me kusht se i njëjti denim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti pas plotfuqishmerise se këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër veper penale.

Në pajtim me nenin 59 dhe 64 të KPRK-se, të akuzuarit i është shqiptuar edhe denimi plotësues, Ndalimi i drejtimit të automjetit për kategorinë B në kohezgjatje prej 1 (një) viti e i cili denim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I akuzuari është obliguar që të paguaje shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarise perfundimtare të gjykatës, për ekspertizën e komunikacionit shumen prej 100 (njëqind) euro, në emër të 4 ekspertizave mjeko ligjore shumen prej 120 (njëqind e njëzet) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzet) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 20 (njëzet) Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerisë së aktgjykimit.

Palet e demtuara A.M., A.M.1, R.M. dhe Z.M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankese ka ushtruar :

Mbrojtësja e të akuzuarit B.Z. – Av.Hidajete Mazhiqi nga Mitrovica, për shkak të vertetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, dhe të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor të i shqiptohet dënimi dukshëm më i ulët me burgim të kushtëzuar se sa denimi i shqiptuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, e gjithashtu të i hiqet denimi plotësues, e me të cilin dënimi do të arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-së.

Prokurori i Apelit të Kosovës, duke u shpjeguar përkitazi me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit B.Z., me shkresën e vet PPA.II.nr. 1692/2023 të datës 29.12.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit të Kosovës, ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit ta refuzojë si të pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të vertetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-së, në të cilën nuk i ftoi palet ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me dënim burgimi të kushtëzuar dhe njoftimi i paleve nuk është i obliguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit, dhe gjeti se :

- Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të Kosovës të njëjtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi për kundër faktit se është atakuar me ankese, ngase i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar të datës 10.10.2023 në bazë të nenit 242 të KPRK-së ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtësja e te akuzuarit B.Z. – Av.Hidajete Mazhiqi, me ankesë pretendon se Gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit te denimit me burgim te kushtezuar dhe denimin plotesues Ndalimi i drejtimit te automjetit, nuk i ka vleresuar drejte dhe ne menyre te duhur rrethanat lehtesuese si faktin se i akuzuari ne fazat e hershme te procedures e ka pranuar fajesine per vepren penale te kryer, ka shprehur keqardhje, ka premtuar se ne te ardhmen nuk do te kryeje vepra penale, se i njeiti me pare nuk ka gene i denuar, e sikur keto rrethana te ishin vleresuar ne menyre te duhur eshte dashur qe te akuzuarit te i shqiptohet nje denim me i ulet me burgim te kushtezuar, e me te cilin denim do te arrihej qellimi i denimit i parapare me nenin 38 te KPRK-se, andaj ka propozuar qe ankesa e mbrojteses se te akuzuarit te aprovohet si e bazuar edhe ne raport me denimin plotesues dhe ate nga arsyeja se i akuzuari punon ne nje firme ndertimore ku bene asfaltimin e rrugeve dhe shqiptimi i ketij denimi do te i'a pamundesonte te njejit punen dhe do te veshtirsohej gjendja e tij ekonomike familjare.

Gjykata e Apelit e Kosoves, vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me sanksionin penal te mbrojteses se te akuzuarit per shqiptimin e denimit me te ulet me burgim te kushtezuar dhe heqjen e denimit plotesues, dhe pas vleresimit te njejtës, dhe duke i patur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata e shkalles se pare drejte dhe ne menyre te plote i ka vleresuar rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 te KPRK-se te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj konstaton se denimi i shqiptuar me burgim te kushtezuar si dhe denimi plotesues ndaj të akuzuarit nga ana e gjykates se shkallës së parë jane në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të vepres penale të kryer, sidomos duke patur parasysh faktin se ne rastin konkret kane pesuar lendime 4 persona dhe ate e demtuara Z.M., ka pesuar lendime te renda trupore, andaj e refuzoi si te pabazuar ankesen e mbrojteses se te akuzuarit per shqiptimin e denimit me te ulet me burgim te kushtezuar dhe heqjen e denimit plotesues, dhe e vërtetoi aktgjykimin e ankimuar te Gjykates se shkalles se pare, e me bindje se me denimin e shqiptuar nga ana e Gjykates se shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1660/23 më 02.02.2024

Procesmbajtësi
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Mehmet Ndrecaj

Ferit Osmani
